



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT**  
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 334 / Prot.  
1

Patos, më 13 / 02 / 2026



**PROJEKTVENDIM**

Nr. 09, datë 13 / 02 / 2026

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT “NGRITJA E SHËRBIMIT TË LOGOPEDISË NË QENDRËN MULTIFUNKSIONALE” DHE VLERËN E BASHKËFINANCIMIT TË TIJ**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Vendimit nr. 82, datë 17.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Patos “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projekt-buxhetit afatmesëm 2026-2028”, VKB nr. 48, datë 18.08.2025 “Për miratimin e Planit Social 2025-2028”, ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 111, datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, V.K.M nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe bazuar në Udhëzuesin për Fondin Social 2026 “Për paraqitjen e kërkesave për njësitë e qeverisjes vendore”, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

**KËRKOJMË:**

- I. Miratimin e projektit “Ngritje e shërbimit të logopedisë në qendrën multifunkionale” për vitin 2026-2028.

Vlera e financimit për këtë projekt do të mbulohet si më poshtë:

Viti 2026 - 90% Fondi Social, 10% bashkëfinancim Bashkia

Viti 2027 - 60% Fondi Social, 40% bashkëfinancim Bashkia

Viti 2028 - 30% Fondi Social, 70% bashkëfinancim Bashkia

- II. Bashkëfinancimi për vitin 2026, 10% do të mbulohet nga buxheti i këtij viti në programin “Çështje sociale”, në produktin “Mbulimi bashkëfinancim ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale”.
- III. Shtim shërbimi logopedie (me një logoped), paga e të cilit do të mbulohet nga fondi social sipas ndarjes së financimit mësipër.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Financës.
- V. Vendimi hyn në fuqi sipas ligjit.

**Ekipi i Menaxhimit të Programit**

Mitjon Nikolla

Barie Goxhaj

Grisilda Muçaj

Dorian Shpata

Albora Sulaj

Lindita Qalliaj

Endri Çako

**Juristi**

Joana Sherifi

**Koordinatori i GMS**

Ina Sauli

**Sekretare e GMS**

Mimoza Shtëmbari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT**  
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 334 / Prot.  
12

Patos, më 13 / 02 / 2026

**RELACION**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT “NGRITJA E SHËRBIMIT TË LOGOPEDISË NË QENDRËN MULTIFUNKSIONALE” DHE VLERËN E BASHKËFINANCIMIT TË TIJ**

Bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Vendimit nr. 82, datë 17.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Patos “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projekt-buxhetit afatmesëm 2026-2028”, VKB nr. 48, datë 18.08.2025 “Për miratimin e Planit Social 2025-2028”, ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 111, datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, V.K.M nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe bazuar në Udhëzuesin për Fondin Social 2026 “Për paraqitjen e kërkesave për njësitë e qeverisjes vendore”, në muajin Shtator 2025, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Kulturës dhe Sportit aplikoi pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me projekt-propozimin “Ngritje e shërbimit të logopedisë në qendrën multifunksionale” i cili u miratua me shkresën me nr. 454/27 prot., datë 26.01.2026 si dhe lidhja e marrëveshjes bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Social Shtetëor dhe Bashkisë Patos me nr. 1456 prot., datë 11.02.2026 SHSSH dhe nr. 569 prot., datë 11.02.2026 Bashkia Patos.

Qëllimi kryesor është krijimi i një shërbimi të specializuar logopedik pranë Qendrës Multifunksionale, i cili të ofrojë mbështetje profesionale për fëmijët dhe individët me vështirësi në të folur, të kuptuar dhe të komunikuar. Referohen rreth 55 raste të fëmijëve me probleme në zhvillimin e të folurit, ndërkohë që numri mund të jetë më i lartë.

**Objektivat e këtij projekti janë:**

**Objektivi 1-** Të sigurohet akses falas në shërbimet logopedike për fëmijët me probleme të zhvillimit të të folurit.

**Objektivi 2-** Të identifikohen herët vonesat dhe çrregullimet e gjuhës dhe komunikimit.

**Objektivi 3-** Të ofrohen terapi individuale dhe në grup sipas nevojës së çdo fëmije.

**Objektivi 4-** Të fuqizohen prindërit përmes këshillimit dhe përfshirjes së tyre në procesin terapistik.

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj dhe vlera totale do të jetë **11,318,904** (njëmbëdhjetë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e katër ) lekë prej të cilave vlera **6,941,668** (gjashtë milion e nëntëqind e dyzetë e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë do të jetë financim nga MSHMS dhe vlera **4,377,236** (katër milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë do të jetë bashkëfinancim nga buxheti i bashkisë. Vlerë ku kjo e fundit ndahet **në vitin 2026 në 388,897** (treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, **për vitin 2027 në vlerën 1,455,587** (një milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë dhe **në vitin 2028 në vlerën 2,532,752** (dy milion e pesëqind e tridhjetë e dymijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë. Bashkëfinancimi për vitin 2026, 10% do të mbulohet nga buxheti i këtij viti në programin “Çështje sociale”, në produktin “Mbulimi bashkëfinancim ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale”, për sa më sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkiak:

- I. Miratimin e projektit “Ngritje e shërbimit të logopedisë në qendrën multifunksionale” për vitin 2026-2028 .
  - I.a Vlera e financimit për këtë projekt do të mbulohet si më poshtë:
    - Viti 2026 - 90% Fondi Social, 10% bashkëfinancim Bashkia
    - Viti 2027 - 60% Fondi Social, 40% bashkëfinancim Bashkia
    - Viti 2028 - 30% Fondi Social , 70% bashkëfinancim Bashkia
- II. Bashkëfinancimi për vitin 2026, 10% do të mbulohet nga buxheti i këtij viti në programin “Çështje sociale”, në produktin “Mbulimi bashkëfinancim ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale”.
- III. Shtim shërbimi logopedie (me një logoped), paga e të cilit do të mbulohet nga fondi social sipas ndarjes së financimit mësipër.
- IV. Vendimi hyn në fuqi sipas ligjit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Financës
- VI. Vendimi hyn në fuqi sipas ligjit.



**Ekipi i Menaxhimit të Programit**

Mitjon Nikolla

Barie Goxhaj

Grisilda Muçaj

Dorjan Shpata

Albora Sulaj

Lindita Qalliaj

Endri Çako

**Juristi**

Joana Sherifi



**Koordinatori i GMS**

Ina Sauli

**Sekretare e GMS**

Mimoza Shtëmbari